

Vendim nr. 202, datë 16.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimi, Anëtar

në datën 16.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (R) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ROZETA MUSABELLIU, XHOANA MERKAJ**, përfaqësuar nga avokati Altin Isufi, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 23/2017-661/333, datë 06.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr. 20-2017-997/534, datë 26.12.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2025-654 (78), datë 12.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatën kompetente, me detyrimin që kërkueset të thirren dhe të marrin pjesë si palë në zbatim të nenit 207 të Kodit Civil dhe parimeve të procesit të rregullt ligjor. Pezullimi i zbatimit/ekzekutimit të vendimeve të kundërshtuara dhe të çdo veprimi përmbarimor /administrativ të bazuar në to, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 71 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe**

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 1476, datë 26.02.2010, ka vendosur detyrimin e shtetasit F.M. t’i kthejë një shtetasi shumë 30.241.082 lekë, me interes ditor 4.351 lekë deri në ditën e ekzekutimit. Kreditori ka filluar procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë në lëvizje shërbimin përmbarimor privat. Zyra përmbarimore, në funksion të vjeljes së detyrimit, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative për një pasuri të paluajtshme (godinë trekatëshe me sipërfaqe 446 m² dhe truall me sipërfaqe 199 m²), të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasit F.M. dhe të një personi të tretë, përkatësisht në raportet 40% dhe 60%.

Procesi i pjesëtimit të pasurisë

2. Për të ekzekutuar vendimin zyra përmbarimore i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me kërkesëpadi për pjesëtimin e pasurisë, me qëllim veçimin e pjesës takuese të shtetasit F.M. Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë kërkesja Rozeta Musabelliu, në atë kohë bashkëshorte e shtetasit F.M., me anë të përfaqësuesit të saj me prokurë të posaçme, avokatit F.C., në seancën e datës 07.12.2012 ka paraqitur një kërkesë për të ndërhyrë në proces në cilësinë e ndërhyrësit kryesor, për shkak të pretendimit se ishte bashkëpronare në pasurinë që do të pjesëtohej. Kjo kërkesë është rrëzuar nga gjykata me pretendimin se kërkesja ishte në një tjetër proces gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë me F.M. të hapur në datën 04.09.2012, i cili nuk kishte përfunduar, si dhe për shkak se kjo ndërhyrje do të vështirësonte së tepërmi hetimin gjyqësor.

3. Në përfundim të fazës së parë të pjesëtimit, me vendimin e datës 12.04.2013, ajo gjykatë ka vendosur lejimin e pjesëtimit të pasurisë në raportin shtetasi F.M. 40% ose 2/5-ën pjesë të sendit dhe personi i tretë 60 % ose 3/5-ën pjesë. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit

Gjirokastrë me vendimin nr. 440, datë 17.09.2013, ndërsa me vendimin nr. 1699, datë 25.05.2016, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të shtetasit F.M.

4. Me marrjen formë të prerë të vendimit për fazën e parë të pjesëtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka proceduar me fazën e dytë dhe gjatë gjykimit ka vendosur edhe kryerjen e aktit të ekspertimit për mënyrat e pjesëtimit të pasurisë. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 23-2017-661/333, datë 06.04.2017, ajo gjykatë ka vendosur pranimin e padisë së zyrës përmbartimore, lejimin e pjesëtimit të pasurisë, duke përfutur shtetasi F.M. 40% ose 2/5-ën në pjesë ideale dhe personi i tretë 60% ose 3/5-ën në pjesë ideale; njohjen e së drejtës së bashkëpronarëve të mbajnë në pronësi të tyre sipërfaqet e pasurisë sipas variantit të dytë të aktit të ekspertimit; detyrimin e personit të tretë bashkëpronar të kompensojë shtetasin F.M. për sipërfaqen prej 3,20 m² që ai përfiton më shumë, në vlerën 89.600 lekë; lënien e sipërfaqeve të tjera ambiente të përbashkëta midis dy bashkëpronarëve. Kundër këtij vendimi shtetasi F.M. ka paraqitur apel, duke pretenduar, ndër të tjera, se pasuria objekt pjesëtimi ishte fituar gjatë martesës dhe, si e tillë, pjesa e tij ishte në bashkëpronësi edhe të bashkëshortes, kërkueses Rozeta Musabelliu. Sipas tij, vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk e ka marrë parasysh këtë fakt dhe nuk e ka thirrur atë në gjykim, duke cenuar kështu të drejtën e bashkëshortes për sa i takon sendit.

5. Me vendimin nr. 20-2017-997/534, datë 26.12.2017, Gjykata e Apelit Gjykoastër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ai ishte marrë në respektim të neneve 372 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Për sa u përket pretendimeve të shtetasit F.M. për thirrjen në gjykim të bashkëshortes, gjykata e apelit ka vënë në dukje se në vendimin për fazën e parë të pjesëtimit ishin përcaktuar sendi objekt pjesëtimi, bashkëpronarët dhe pjesët e tyre takuese dhe, sipas qëndrimit unifikues të Gjykatës së Lartë, problemet e zgjidhura në fazën e parë të pjesëtimit përbënin gjë të gjykuar e nuk mund të merreshin në shqyrtim.

6. Shtetasi F.M. ka ushtruar rekurs ndaj vendimit, duke ngritur të njëjtin pretendim. Me vendimin nr. 00-2025-654 (78), datë 12.02.2025, në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke vlerësuar, ndër të tjera, se pretendimet e rekursuesit për përkatësinë e të drejtave të pronësisë për sendin ishin adresuar drejt nga ajo gjykatë. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i fazës së parë të pjesëtimit është *sui generis*, i cili ka zgjidhur në themel dhe në mënyrë përfundimtare çështjet lidhur me sendet që i

nënshtroheshin pjesëtimit, rrethin e bashkëpronarëve dhe përkatësinë e pjesëve. Ai kishte marrë formë të prerë, pasi ishin ezauruar të gjitha shkallët e ankimit, duke zgjidhur në mënyrë përfundimtare përkatësinë e pjesëve të secilit bashkëpronar në sendin objekt pjesëtimi. Sipas Gjykatës së Lartë, bazuar në vendimin unifikues nr. 628, datë 15.05.2000 të saj, gjatë fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë gjykata nuk kishte të drejtë të shqyrtonte problemet për gjykimin e fazës së parë. Për pasojë, në përlllogaritjen e pjesëve që u takonin palëve ndërgjyqëse në këtë pasuri, ato ishin pasqyruar saktë në vendimin gjyqësor dhe nuk mund të vlerësoheshin rishtazi, pasi ishin zgjidhur me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit.

7. Në datën 05.08.2025 shtetasi K.M. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna në fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë. Me vendimin nr. 251, datë 09.10.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, me arsyetimin se ai nuk legjitimohej *ratione personae*, pasi pretendimet e tij kishin të bënin me faktin se bashkëshortja e tij (kërkuesja Rozeta Musabelliu) nuk ishte thirrur në gjykimin e pjesëtimit të pasurisë dhe, për rrjedhojë, ai nuk justifikonte interesin vetjak në çështjen e parashtruar.

Procesi i zgjidhjes së martesës

8. Ndërkohë, me vendimin nr. 4333, datë 14.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur zgjidhja e martesës ndërmjet kërkueses Rozeta Musabelliu dhe shtetasit F.M. Në këtë vendim ajo gjykatë nuk është shprehur për ndarjen e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, pasi palët, me anë të një aktmarrëveshjeje për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok të lidhur para noteres në datën 13.04.2017, kishin rënë dakord që të nënshkruanin një marrëveshje të veçantë për regjimin martesor dhe vazhdimësinë e tij pas martese, përfshirë këtu edhe pjesën takuese të pasurisë objekt gjykimi të vendimeve të pjesëtimit të pasurisë.

9. Në datën 25.07.2023 është nënshkruar një kontratë dhurimi e pasurisë së paluajtshme midis shtetasit F.M. në cilësinë e dhuruesit, si dhe kërkueseve, Rozeta Musabelliu dhe Xhoana Merkaj (vajza e tij). Objekti i kësaj kontrate është pasuria objekt i vendimeve të pjesëtimit. Në kontratë theksohet se pasuria është fituar gjatë martesës dhe si e tillë kërkuesja Rozeta Musabelliu, ka 1/2-ën pjesë të bashkëpronësisë të 4/10-ve pjesë të pasurisë, pasi dhuruesi është bashkëpronar me C.K., e cila ka 6/10-at pjesë ideale. Gjithashtu, në kontratë theksohet se dhuruesi i dhuron

vajzës së tij, kërkueses Xhoana Merkaj, 1/2-at e 4/10-ve, duke u zhveshur tërësisht nga pjesa e tij takuese dhe se është dakord që për pjesën e tij takuese të pajisen me certifikatë pronësie ish-bashkëshortja e tij (kërkuesja Rozeta Musabelliu) dhe vajza e tij Xhoana Merkaj. Kjo kontratë është regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe ndryshimi është pasqyruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme, ku rezultojnë bashkëpronare C.K. me 6/10-at pjesë takuese, kërkuesja Xhoana Merkaj me 2/10-at pjesë takuese dhe kërkuesja Rozeta Musabelliu me 2/10-at pjesë takuese.

10. Në datën 20.02.2026 kërkueset i janë drejtuar Gjykatës, sipas objektit, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna në fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë dhe duke kërkuar edhe pezullimin e zbatimit dhe ekzekutimin e këtyre vendimeve, si dhe çdo veprim përmbartimor administrativ bazuar në to deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata.

II

Pretendimet e kërkueseve

11. **Kërkueset**, në mënyrë të përmbledhur kanë pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

11.1. *Të drejtën për proces të rregullt*, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të:

11.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi gjykatat kanë vendosur për një marrëdhënie reale të pronësisë pa thirrur të gjithë personat që pretendojnë se janë bashkëpronarë dhe pa verifikuar në mënyrë të plotë rrethin e subjekteve që preken. Në këtë mënyrë, gjykatat kanë lejuar pjesëtimin e pasurisë pa thirrur kërkueset, duke i përjashtuar ato *de facto* nga procesi gjyqësor. Pasuria që i është nënshtruar pjesëtimit është pjesë e regjimit martesor të bashkësisë ligjore, për rrjedhojë gjykatat duhet të verifikonin rrethin e bashkëpronarëve, duke i thirrur ata si palë në proces. Pjesëtimi i pasurisë për qëllime ekzekutimi nuk mund të shtrihet automatikisht mbi të gjithë pasurinë e bashkësisë, duke anashkaluar bashkëshortin jodebitor. Kërkueses Rozeta Musabelliu i është hequr mundësia për të ngritur pretendime në lidhje me kufijtë e përgjegjësisë së bashkësisë, si dhe për të paraqitur ankim për vendimet gjyqësore. Ndonëse

ligji njih të drejtën e personit të tretë për të kundërshtuar ekzekutimin kur ai prek pasurinë e tij, nuk e zëvendëson detyrimin e gjykatave për të thirrur të gjithë bashkëpronarët në gjykimin e pjesëtimit. Për këto shkaqe atyre u janë cenuar edhe *e drejta për t'u dëgjuar, e drejta e ankimit, si dhe parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*.

11.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi në regjistrat publikë janë shënuar kufizime dhe masa mbi pasuri që u përkasin kërkueseve dhe për këtë shkak ato janë të detyruara të ndjekin një sërë procedurash pasuese për të rikthyer të drejtën e cenuar. Në kushtet kur kërkueset nuk janë marrë pjesë në gjykim, vendimet gjyqësore kanë prodhuar pasiguri juridike.

11.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjatë procesit gjyqësor është krijuar pabarazi ndërmjet palëve dhe kërkueset janë privuar tërësisht nga garancitë procedurale.

11.3. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi vendimet e kundërshtuara kanë shërbyer si bazë për regjistrimin e masave kufizuese dhe të sekuestros mbi pasuri që ato pretendojnë se u përkasin, duke kufizuar disponimin e tyre dhe duke krijuar rrezik për tjetërsimin e pasurive në kuadër të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm. Ndërhyrja në të drejtat e tyre pasurore është kryer pa garantuar më parë pjesëmarrjen e tyre në procesin gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueseve

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin

përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

14. Në rastin konkret Kolegji çmon të ndalet në kriterin paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kolegji vëren se kërkuueset kanë kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme të cilat kanë vendosur në lidhje me fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë mbi një pasuri që ato

pretendojnë se janë bashkëpronare. Lidhur me këtë pasuri është kërkuar pjesëtimi me qëllim veçimin e pjesës takuese të shtetasit F.M. (ish-bashkëshorti dhe babai i kërkueses), për shkak të përmbushjes së një detyrimi civil që ky i fundit ka ndaj shtetasit S.B. Ndërkohë rezulton se kërkuësja Rozeta Musabelliu ka paraqitur një kërkesë për të ndërhyrë në proces në fazën e parë të pjesëtimit në cilësinë e ndërhyrësit kryesor, kërkesë e cila është rrëzuar nga gjykata. Faza e parë e pjesëtimit ka përfunduar me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 25.05.2016. Nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual nuk rezulton që kërkuëset të kenë ushtruar ankim ndaj vendimeve gjyqësore që kanë disponuar për këtë fazë të pjesëtimit, por kanë kundërshtuar vetëm vendimet e dhëna më pas në kuadër të fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme.

16. Për sa më lart, Kolegji evidenton se nga përmbajtja e ankimit kushtetues individual, thelbi i pretendimeve të kërkuëseve lidhet me faktin se ato nuk janë njohur si bashkëpronare të pasurisë objekt pjesëtimi dhe nuk janë thirrur si palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Megjithatë, Kolegji vëren se këto çështje janë objekt i fazës së parë të gjykimit për pjesëtimin e pasurisë, në të cilën gjykata përcakton sendin objekt pjesëtimi, rrethin e bashkëpronarëve dhe pjesët takuese të secilit prej tyre. Në këtë fazë kërkuësja Rozeta Musabelliu ka kërkuar të marrë pjesë në proces, por kërkesa e saj është rrëzuar nga gjykata. Kolegji evidenton se ky qëndrim i gjykatës, si edhe përcaktimet e bëra në vendimin e fazës së parë lidhur me rrethin e bashkëpronarëve, mund të kundërshtoheshin nëpërmjet ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, sipas neneve 442 e vijues të KPC-së. Megjithatë, Kolegji konstaton se kërkuëset nuk kanë ndjekur këtë rrugë procedurale, por kanë kundërshtuar drejtpërdrejt në Gjykatë vetëm vendimet e dhëna në fazën e dytë të pjesëtimit, bazuar në nenet 369–374 të KPC-së, në të cilat gjykatat janë kufizuar në përcaktimin e mënyrës konkrete të realizimit të pjesëtimit, në përputhje me vendimin e formës së prerë të fazës së parë, pa rivlerësuar çështjet që lidhen me rrethin e bashkëpronarëve ose pjesët takuese të tyre.

17. Në këto kushte, Kolegji çmon se vendimet objekt kundërshtimi nuk kanë vendosur mbi të drejtat e kërkuëseve si bashkëpronare të pasurisë, pasi kjo çështje është zgjidhur përfundimisht me vendimin e dhënë në fazën e parë të pjesëtimit. Për sa kohë që ankimi kushtetues është drejtuar vetëm kundër vendimeve të fazës së dytë, të cilat nuk përmbajnë vlerësime mbi këto çështje, pretendimet e tyre nuk mund të shqyrtohen në kuadër të këtij gjykimi, pasi kërkuëset nuk kanë kundërshtuar, nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit, vendimin e fazës së parë të pjesëtimit,

në të cilin janë përcaktuar rrethi i bashkëpronarëve dhe pjesët takuese të tyre. Për rrjedhojë, kërkuueset nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive ndaj vendimeve që kanë sjellë cenimin e të drejtave kushtetuese.

18. Duke pasur parasysh se kriteret e legjitimitetit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues kanë karakter kumulativ, Kolegji vlerëson se nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kriterëve të tjera të pranueshmërisë së kërkesës.

19. Për sa i përket kërkesës së kërkuueseve për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se sipas nenit 45 të Ligjit Organik të Gjykatës masa e pezullimit vendoset nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose nga Gjykata, pra kur vlerësohet se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë plenare. Në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes kjo kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.